



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS  
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 162 / 12 Prot.

Datë 29.1.2024

**V E N D I M**

Nr 6 , datë 29.1 .2024

**PËR  
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 48, DATË 28.12.2015**

Në mbështetje të shkronjës ç), të pikës 1, të nenit 248 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.325, datë 31.5.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendës ministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”; të ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës i mbledhur më datë 29.01.2024,

**V E N D O S I:**

1. Në strukturën organizative të Shkollës së Magjistraturës, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 48, datë 28.12.2015, (i ndryshuar), në përbërjen e Sektorit të Studimeve dhe Publikimeve pranë Departamentit të Kërkimeve Shkencore dhe Publikimeve shtohet pozicioni 1 (një) sekretar shkencor për publikimet dhe komunikimin sipas organigramës dhe lidhjes nr.1 bashkëngjitur, pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Miratimin e përshkrimit të punës për pozicionin sekretar shkencor për publikimet dhe komunikimin, bashkëngjitur, si pjesë e pandarë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.